



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
*Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë- Ministarstvo za Obrazovanje, Nauke i
Tehnologija--Ministry of Education Science and Technology*

Kabineti i Ministrit/Cabinet of the Ministry/Kabinet Ministra/

Numër: 250/01B

Datë: 09/02/2018

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010) si dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të nenit 20 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011), nenit 8 të Ligjit nr. 05-L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 2 / 08 janar 2016, nxjerr:

V E N D I M

Për emërimin e Komisionit Shtetëror të Maturës

1. Emërohet Komisioni Shtetëror i Maturës, me mandat trevjeçar më këtë përbërje:
 - 1.1 Fehmi Hysenaj, kryetar
 - 1.2 Arben Dërmaku, nënkryetar
 - 1.3 Agim Berdyna, anëtar
 - 1.4 Mustaf Kadriu,(DVSM) anëtar pa të drejtë vote
 - 1.5 Arsim Ejupi, anëtar
 - 1.6 Ajka Aliu, anëtar
 - 1.7 Besim Gollopeni, anëtar
 - 1.8 Ilmi Ratkoceri, anëtar
 - 1.9 Lendita Pula, anëtar
 - 1.10 Musa Nikçi, anëtar
 - 1.11 Majlinda Hoxha, anëtar
 - 1.12 Sahit Berisha, anëtar
2. Komisioni Shtetëror i Maturës (KSHM) është organ mbikëqyrës, këshillues dhe vendimmarrës për të gjitha çështjet lidhur me maturën.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit Shtetëror të Maturës janë:

- 3.1 Të miratojë listën e anëtarëve të komisioneve të lëndëve për përpilimin e kërkesave për provimin shtetëror të maturës me propozimin e qendrës së vlerësimit;
 - 3.2 Të obligoj DKA-në për grumbullimin e të dhënave për kandidatët e provimit të maturës sipas udhëzimeve të qendrës së vlerësimeve;
 - 3.3 Të bëjë planifikimin dhe përgatitjen për organizimin e provimit të maturës për vitin e ardhshëm në bashkëpunim me qendrën e vlerësimit më së largu deri me 31 dhjetor;
 - 3.4 Të marrë opinionet nga komuniteti për mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit dhe mbi këto opinione të nxjerrë udhëzime dhe caktoj përgjegjësit për subjektet në procesin e provimit të maturës;
 - 3.5 Të miratojë katalogun e lëndëve dhe të bëjë harmonizimin e lëndëve për provimin e maturës, në përputhje me planprogramet mësimore sipas drejtimeve, respektivisht profileve;
 - 3.6 Gjatë kohës së administrimit të testit në qendrat e testimit, angazhon ekipet e shërbimit shëndetësor si dhe cakton mënyrën për ruajtjen e sekretit në provimin e maturës dhe në provimin përfundimtar;
 - 3.7 Publikon rezultatet e testit në marrëveshje me MASHT.
 - 3.8 I raporton me shkrim në baza periodike Ministrin lidhur me përgatitjet për organizimin e provimit të maturës dhe mbi mbarëvajtjen e procesit të vlerësimit.
4. Afrim Rrahmani, emërohet sekretar i Komisionit Shtetëror të Maturës.
 5. Kompensimi i anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Maturës, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga Ministri

Arsyetim

Duke u bazuar në dispozitat e lartshënuara, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Maturës;
2. Kabinetit të Ministrin;
3. Sekretarit të përgjithshëm të MASHT;
4. Departamentit të Arsimit Parauniversitar;
5. Departamentit Ligjor;
6. Arkivit



Shyqiri Bytyqi, ministër

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë